REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA AKSIONARE UJËSJELLËS KANALIZIME POLIÇAN
**ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E SHOQËRISË**

Nr. 1136 Prot. Poliçan më, 25/ 04/ 2023

**VENDIM**

**NR. 73 DATË 25 / 04/2023**
**PËR**

**PËRFUNDIMIN E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ,SHPALLJEN E SAJ NË LIKUIDIM DHE EMERIMIN E LIKUIDATORIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, sot, më datë 25 Prill 2023, Shoqeria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J69102446I, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administrator shoqërisë zoti Besmir Doko, për të diskutuar rmbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërim I Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit te ditës, Asambleja vëren:**

Shoqeria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr.4853Rep. dheNr. 2760Kol, datë17.11.2022 midis shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasidiskutoigjerësishtmbirendin e ditës, Asambleja**

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan dhe prishjen e saj
2. Shoqëria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Poliçan shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
3. Emërimin e Z. BesmirDoko si likuidator të shooqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime

4. Likuidatori është I autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu I autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në perputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqe së çdo document të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.

Ky vendim hynë menjëherë në fuqi,

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMË E AKSIONARËVE

KRYETARI I BASHKIS POLIÇAN

Adriatik ZOTKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POLIÇAN